

VENDIM
Nr. 1022, datë 27.11.2013

PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR DISA INSTITUCIONE TË VARËSISË, ME FONDET E MIRATUARA NË BUXHETIN E VITIT 2013 PËR KËTË MINISTRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të ligjit nr. 9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë, si autoritet kontraktues, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik për disa institucione të varësisë, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2013 për këtë ministri, për objektet sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

Procedurat e prokurimit me objekt:

1. SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë:
“Blerje biomasë (Pellet) për ngrohje të institucionit”, me fond limit 5.800.000 lekë me TVSH.
2. Drejtoria e spitalit Lushnjë:
“Blerje lëndë djegëse për kaldajën (Solar), fondi limit 1.500.000 lekë me TVSH.
3. Shërbimi Spitalor Pogradec:
“Blerje karburanti për ngrohje për kaldajën e spitalit”, fondi limit 2.630.833 lekë pa TVSH.
4. Shërbimi Spitalor Kurbini:
“Blerje lëndë djegëse për kaldajën (Solar)”, fondi limit 666.667 lekë me TVSH.
5. Spitali Psikiatrik Elbasan:
“Blerje materiale të buta për Spitalin Psikiatrik Elbasan”, fondi limit 4.203.000 lekë me TVSH.